



Funded by
the European Union



Roli i Shoqërisë Civile në luftën kundër korrupsionit

Ina Xhepa

** Ina gëzon mbi 10 vjet ekspertizë profesionale në të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtën Evropiane. Aktualisht ajo është në pozicionin e Drejtores Ekzekutive të Qendrës Evropiane, duke qënë një zë i fuqishëm i shoqërisë civile në Shqipëri për kauza të ndryshme sociale. Ina është e diplomuar për Drejtësi dhe Financë-Kontabilitet.*

Nëntor 2023

Ky artikull u realizua në kuadër të projektit “Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane!”, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e autorit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.



“Nëse duam të kemi zhvillime të rëndësishme, duhet të bashkëpunojmë me shoqërinë civile.”

Nelson Mandela

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) janë aktorë joshtetërorë që bashkojnë njerëzit për të çuar përpara qëllimet dhe interesat e përbashkëta.¹ Në një shtet në zhvillim, siç është Shqipëria, shoqëria civile luan një rol kyç dhe thelbësor për zhvillimin e vendit duke ushtruar presion ndaj institucioneve për të rritur nivelin e transparencës. Konkretisht, ndikimi më i domosdoshëm i shoqërisë civile është ai mbi luftën anti-korrupsion si nevoja më prioritare e vendit, që ndikon në mënyrë të menjëhershme në zhvillimin e tij, në kudër të procesit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

OSHC-të hasin pengesa në ushtrimin e plotë të funksioneve të tyre për të kanalizuar shqetësimet e qytetarëve në proceset e politikave përmes mekanizmave të duhur të pjesëmarrjes dhe konsultimit të vërtetë.² Për të shmangur, parandaluar apo frenuar korrupsionin përfshirja e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse është domosdosshmëri. Që ky aktivizim i shoqërisë civile të jetë real, dhe ndikues mbi të gjitha, duhet marrë në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm: *së pari bashkëpunimi me institucionet duhet të jetë me i ngushtë dhe më i shpeshtë; së dyti kontributet e shoqërisë civile duhet të merren në konsideratë nga institucionet pasi jo rrallë herë shohim që takimet janë fiktive dhe thjeshtë proceduriale; së treti, dhe më e rëndësishmja e cila është edhe një nga problematikat ku BE vendos theksin më së shumti, është krijimi i një mjedisi mundësues për OSHC-të dhe rimbursimin e TVSH-së.*

Megjithatë, ndërgjegjësimi për ndikimin e shoqërisë civile në të gjitha proceset me ndikim në shoqëri është rritur pasi koncepti unik i shoqërisë civile si “hapësira ku veprojmë për të mirën e përbashkët” po zgjerohet, duke pasur parasysh se aktorët e shoqërisë civile luajnë shpesh rolin e lehtësuesit në nxitjen e ndryshimit në bashkëpunim me aktorët e tjerë.³ Në këtë kuadër, mekanizmat e përdorur më shpesh nga ministrinë e linjës për konsultime me shoqërinë civile janë publikimi në internet i projekt politikave, strategjive dhe akteve; thirrja e hapur për rekomandime nga grupet e interesit; dhe organizimi i takimeve këshillimore.⁴ Një nga mekanizmat e Kuvendit për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin legjislativ është botimi i një kalendari të punimeve dhe aktiviteteve përkatëse të komisioneve parlamentare.⁵ Tashmë në më shumë se 4 vite janë ngritur edhe Platformat e Partneritetit për Integrimin Evropian, të cilat kanë një bazë të mirë ligjore për funksionimin e tyre dhe kanë si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian duke krijuar mundësi për përthithjen e

¹Roli i Shoqërisë Civile në Bashkimin Evropian dhe Shqipëri

² Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri- <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>

³ Po aty

⁴ Po aty

⁵ Po aty

ekspertizës vendase në fushat përkatëse. Ndër 33 tryezat e PPIE mund të përmendim kontributin e vazhdueshëm të shoqërisë civile nëpërmjet Platformës së Partneritetit të Integritit Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” drejtuar nga Ministria e Drejtësisë në të cilin mbulohen dhe politikat anti-korrupsion.

Me ndikimin e ndërkombëtarëve, presioni për ndryshim është i madh. Mund të përmendim këtu, ndër shumë të tjera dhe përveç rekomandimeve direkte të BE-së, Planin e Veprimit për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2023-2025 një ndër komponentët e të cilit është edhe lufta kundër korrupsionit. Plani i veprimit për këtë angazhim prioritar përbëhet nga 17 masa/aktivitete, 9 prej tyre të drejtuara nga Qeveria, 8 nga masat e udhëhequra organizatat e shoqërisë civile.

Krijimi i mekanizmave për të rritur ndërgjegjësimin si dhe për të nxitur bashkëpunimin, krijimi i platformave apo forumeve për të shtuar komunikimin mes Qeverisë dhe OSHC-ve, planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta si dhe shpërndarja e infomacionit janë vetëm disa nga hapat që duhen ndërmarrë për të forcuar rolin e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit, e cila gjithashtu duhet të përfshihet në reformat e sundimit të ligjit. Organizatat e shoqërisë civile luajnë role të shumta pasi ato janë një burim i rëndësishëm informacioni si për qytetarët ashtu edhe për qeverinë duke monitoruar politikat dhe veprimet e qeverisë dhe e mbajnë qeverinë përgjegjëse; angazhohen në advokim dhe ofrojnë politika alternative për qeverinë, sektorin privat dhe institucionet e tjera; mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe punojnë për të ndryshuar dhe mbështetur normat dhe sjelljet shoqërore.

Bibliografia

1. Roli i Shoqërisë Civile në Bashkimin Evropian dhe Shqipëri
2. Progres Raporti 2022 për Shqipërinë- <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>
3. Raporti Screening për Shqipërinë- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf
4. Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri- <https://idmalbania.org/ep-content/uploads/2021/11/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>
5. Open Government Partnership Albania 2023-2025 National Action Plan March 2023- https://ogp.gov.al/uploads/2023/4/20230420180313_albania-national-action-plan-2023-2025-ogp-march-2023.pdf